



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVA



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	03.02.2026
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkyetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – JANAR 2026

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2026, ju dorëzon:

RAPORTIN MUJOR
TË PUNËS PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.01.2026-31.01.2026

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- në sektorin e Urbanizmit ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kërkesave të bartura. Gjatë muajit janar 2026-janë pranuar gjithsejtë 46¹-kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura nga muaji paraprak kanë qenë 37 lëndë, në total 83 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 66 kërkesa, 38 të miratuara, 21 të refuzuara, 4 pushim procedure dhe 3 të bartura në kompetencë. Për shqyrtim në muajin vijues (shkurt 2026) barten 17 lëndë të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve të pranuar dhe atyre të bartura është prezantuar në pjesën tabelare.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në fushën e shqyrtimit të kërkesave është vazhduar me intensifikimin e angazhimeve për shqyrtimin e tyre brenda afateve ligjore.

Pjesë e veçantë e shqyrtimit të kërkesave është edhe procedura e lëshimit të konkluzioneve për pagesen e taksave sipas kategorive të caktuara. Lidhur me këte janë lëshuar 13 konkluzione për pagesen e taksave. Prej tyre 3 konkluzione për leje ndërtimi, 2 për leje mjedisore komunale, 2 për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimi, 3 për leje rrënimi dhe 3 për certifikatë legalizimi.

Po, ashtu DPUMM ka përgatitur dhe adresuar te palët ftesa për plotësimin e dokumentacionit. Në kuadër të kësaj janë lëshuar 6 ftesa për kompletim të lëndës. Brenda muajit janar janë pranuar dy kërkesa për plotësimin e lëndëve. Edhe gjatë këtij muaji kishte mjaft kërkesa të drejtpërdrejta (informative) lidhur me ndryshimin/plotësimin e HZK².

Aktivitete të tjera janë kryer edhe si:

Janë përgatitur materialet për Kuvendin e Komunës, duke përfshirë propozim ndryshimin dhe plotësimin e HZK dhe për themelimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve të reja.

Janë proceduar administrativisht të gjitha kërkesat për kryerjen e pagesave sipas detyrimeve të arritura.

Është në zbatim e sipër programi për regjistrimin e adresave zyrtare, proces që zbatohet nga AKK. Proces mbikëqyret dhe mbështetet nga DPUMM. Në këtë proces janë të angazhuar dy punonjës të përkohshëm të cilët e përfundojnë kontratën në fund të muajit shkurt 2026.

Afati për trajtimin e objekteve pa leje ndërtimi është vazhduar edhe për vitin 2026. Ky proces është tepër sfidues.

Aktivitetet themelore për muajin vijues:

- Përgatitja e temave të propozuara për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.
- *Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të bartura;*

¹ Janë pranuar edhe 2 kërkesa të tjera për plotësim dokumentacioni bazuar në kërkesat e parashtruara paraprakisht.

² Këto kërkesa duhet të trajtohen në procesin e ndryshim/plotësimit të HZK-së.

STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Tabela 1.

Nr.	Llojet e kërkesave	Të pranuar	Nga periudha e kaluar	Të miratura	Pushim procedure -pezullim	Të refuzuar	Të bartura në sektor të tjerë	Në proces (pritje)
1.	Kushte ndërtimore	6	2	3		1		4
2.	Leje ndërtimi	4	4	4		1		3
3.	Leje rrënimi	2	1	3				
4.	Certifikatë Përdorimi		2			2		
5.	Shtyrje afati LN	1		1				
6.	QRTK-bartje në kompetencë							
7.	Informacione urbane	6		6				
8.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi		22	3		13		4
9.	Legalizimi/ Në listë të pritjes				2			
10.	Bashkim/ndarje e parcelave	4	1	2	2	1		
11.	Kërkesë për LMK	5	1	3				3
12.	Qasje në dokumente	1		1				
13.	KN për park solar		3				3	
14.	Panele në objekt		1			1		
15.	Ankesë – legalizim	1				1		
16.	Dëshmi për ankesë MMPHI	1		1				
17.	Pëlqim për rrjet energj.	1						1
18.	Pëlqime mjedisore	3		3				
19.	Tërheqje lënde	1		1				
20.	Kërkesë për shpronësim	2						2
21.	Detyrë projektuese	6		6				
22.	Vazhdim i K.ndërtim.	1		1				
23.	Udhëzime procedurale	1				1		
	Gjithsejtë:	46	37	38	4	21	3	17

Sipërfaqja tokësore për ndërtim, sipërfaqja e ndërtesave dhe destinimi

Tabela 2.

Nr.	Kategoria e ndërtimit	Sipërf. Tokës – m2	Sip.ndëtesës- m2	Destinimi	Vendi
1.	II	3700	Bo=937.7 A= 1756.3 Ba=6209.7	NLB	Lipjan

2.	II	2211	Bo=960.7 A= 820.1 Ba=3638.4	NLB	Lipjan
3.	II	3461	Bo=1317.4 A= 487.7 Ba=4219.8	NLB	Lipjan
4.	II	25408	13588.20	Afarist	Konjuh
Gjithsejtë		34780	33936		

Tokë e shfrytëzuar vetëm për afarizëm = 25408 m² me gjithsejtë ndërtim për afarizëm prej 13588.20 m², kurse tokë e shfrytëzuar për banim dhe afarizëm në qytet 9374 m² në të cilën janë ndërtuar 3215.8 m² bodrum, 3064.1 m² afarizëm dhe 14067.9 m² për banim (NLB).

Në bazë të analizës së sipërfaqeve për ndërtim sipas destinimit del se gjatë muajit janar 2026 – rreth 36% e hapësirave të tokës ku është ndërtuar, ndërtesat janë destinuar për banim, kurse rreth 64% e tyre janë destinuar për afarizëm.

Buxheti:

Gjatë muajit janar 2026 të hyrat nga kategoritë e ndryshme nga fusha urbane janë mjaft të larta krahasuar me muajin paraprak.

- Të hyrat për leje ndërtimore janë realizuar në shumë prej:.....139,535.69€
- Të hyrat për ndërrimin e destinimit të tokës në shumë prej:27,619.00€
- Të hyrat për leje mjedisore komunale janë realizuar në shumë prej.....18,529.11€
- Të hyrat për legalizimin e ndërtesave pa leje janë realizuar në shumë prej:.....462.06€
- Të hyrat për Leje rrënimi janë realizuar në shumë prej533.65€

Shuma totale e të hyrave:186,679.51€

Të dhënat lidhur me të hyrat për muajin janar 2026 janë pranuar nga sektori i financave në kuadër të Drejtoratit përkatës të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me shpenzimet kemi proceduar me pagesa për kryerjen e detyrimeve në shumë të përgjithshme prej 2,765.00 € (6 fatura për subjekte të ndryshme). Mjetet e planifikuara për shpenzim janë nga kategoria ekonomike “Mallra dhe shërbime”.

DISKUTIME PUBLIKE:

Gjatë muajit janar 2026 nuk kemi pasur ndonjë diskutim publik.